



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr.1353/6 Prot

Tiranë, më 11.10.2023

VENDIM

Nr.46, datë 11.10.2023

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, “ABC Tirana Club”, përfaqësuar nga z. _____, (në vijim “ankuesi”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1353 prot., datë 11.08.2023, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Ministria e Kulturës (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit, nëpërmjet kërkesës datë 26.07.2023, depozituar në adresën elektronike _____, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni në lidhje me:

1. Sa fonde publike (në vlerë konkrete financiare) ka përfituar konkretisht secili prej aplikuesve (individ ose OJF), i shpallur fitues nga Kolegjiumi i Ministrisë së Kulturës, në kuadër të Thirrjes së vitit 2022 për projekt propozimet në fushën kulturore?
2. Sa fonde publike (në vlerë konkrete financiare) ka përfituar konkretisht secili prej aplikuesve (individ ose OJF), i shpallur fitues nga Kolegjiumi i Ministrisë së Kulturës, në kuadër të Thirrjes së vitit 2021 për projekt propozimet në fushën kulturore?
3. Sa fonde publike (në vlerë konkrete financiare) ka përfituar konkretisht secili prej aplikuesve (individ ose OJF), i shpallur fitues nga Kolegjiumi i Ministrisë së

Kulturës, në kuadër të Thirrjes së vitit 2020 për projekt propozimet në fushën kulturore?

Në mungesë të një përgjigje nga Autoriteti Publik, në përfundim të afatit ligjor, ankuesi i është drejtuar Komisionerit me ankesë, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Komisioneri nëpërmjet shkresës nr. 1353/1 prot., datë 14.08.2023, drejtuar Autoritetit Publik dhe për dijeni ankuesit, ka kërkuar të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Në vijim të shkresës së sipërcituar, Autoriteti Publik nuk ndërmorri asnjë masë për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Zyra e Komisionerit ka kontaktuar në vazhdimësi me koordinatorin për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, i cili ka bërë me dije se informacioni i kërkuar është duke u përgatitur nga strukturat përkatëse të Autoritetit Publik dhe do t’i vendosej në dispozicion ankuesit.

Ankuesi me anë të shkresës datë 05.10.2023, ka informuar se: “*...Autoriteti Publik (Ministria e Kulturës), nuk ka dhënë përgjigje për informacionin e kërkuar...*”, duke vijuar në këtë mënyrë ankimin e rregjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1353/5, datë 05.10.2023.

Në këto rrethana, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar në ankesë, Komisioneri vlerëson se në parim, informacioni/dokumentacioni i kërkuar, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2 të LDI, sipas të cilit “*Informacion publik*” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik”. Në këtë kuptim, Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuarit çdo informacion/ dokumentacion, i cili është prodhuar ose mbahet nga ky i fundit në formën e disponuar në përputhje me parashikimin e pikës 6 të nenit 17 të LDI, sipas të cilit: “*Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim*”.

Bazuar në nenin 1 të ligjit të sipërcituar, përcaktohet qartë se, *objekt i këtij ligji është çdo informacion që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike*. Në këtë kuptim, çdo autoritet publik pavarësisht nëse është në cilësinë e “*prodhuesit*” apo “*mbajtësit*” të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.

Gjithashtu, në shkronjën a) të pikës 2 të nenit 10, të LDI, parashikohet se: “*Koordinatori për të drejtën e informimit... a) i mundëson çdo kërkuesi të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, sipas këtij ligji, duke u konsultuar me dokumentacionin origjinal ose duke marrë një kopje të tij;*”.

LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike.

Komisioneri vlerëson se, se informacioni i kërkuar lidhet me përfitime nga buxheti i shtetit i cili do t’i shërbente transparencës së veprimtarisë së tij në këtë proces.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit për të drejtën e informimit, “*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*”.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e “ABC Tirana Club” ndaj Autoritetit Publik/Ministria e Kulturës, Komisioneri vlerëson se duke pasur parasysh sa është parashtruar më sipër, ankimi është bazuar në ligj dhe si i tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së “ABC Tirana Club”, nr. 1353 prot., datë 11.08.2023, ndaj Autoritetit Publik, Ministria e Kulturës, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 26.07.2023, konkretisht: “*1. Sa fonde publike (në vlerë konkrete financiare) ka përfituar konkretisht secili prej*

aplikuesve (individ ose OJF), i shpallur fitues nga Kolegjiumi i Ministrisë së Kulturës, në kuadër të Thirrjes së vitit 2022 për projekt propozimet në fushën kulturore? 2. Sa fonde publike (në vlerë konkrete financiare) ka përfituar konkretisht secili prej aplikuesve (individ ose OJF), i shpallur fitues nga Kolegjiumi i Ministrisë së Kulturës, në kuadër të Thirrjes së vitit 2021 për projekt propozimet në fushën kulturore? 3. Sa fonde publike (në vlerë konkrete financiare) ka përfituar konkretisht secili prej aplikuesve (individ ose OJF), i shpallur fitues nga Kolegjiumi i Ministrisë së Kulturës, në kuadër të Thirrjes së vitit 2020 për projekt propozimet në fushën kulturore? ”, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, brenda datës 18.10.2023.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 11.10.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi